



This project is funded by
the European Union




KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT



Hedayah
countering violent extremism

"Aktivitete edukative të bazuara në vlera, për të parandaluar Ekstremizmin e Dhunshëm tek të rinjtë në Shqipëri"

Kohëzgjatja:
Dhjetor 2019 – Dhjetor 2020



Objekivi i përgjithshëm i projektit – parandalimi i radikalizmit që çon në ekstremizëm të dhunshëm, nëpërmjet përmirësimit të edukimit të bazuar në vlera dhe kuptimin më të mirë të fesë në 12 qarqe të Shqipërisë. Projekti mbështetet nga Hedayah dhe financohet nga Bashkimi Evropian.

A e dini se: në vitin 2018 të dhënat alarmante të INSTAT treguan se më shumë se 1/3 e popullsisë shqiptare nuk ka lexuar kurrë një libër?

Ky projekt siguron për 24 shkolla të mesme, burime të mjaftueshme të 12 titujve të ndryshëm librash për të rinjtë, me qëllim përdorimin e letërsisë për një edukim bazuar në vlera!

Pse? Librat e përzgjedhur edukojnë vlerat thelbësore të rëndësishme për shoqërinë shqiptare, por edhe vlera universale siç janë respekti i ndërsjellë, gjithpërfshirja, respekti për familjen, mos përdorimi i gjuhës së urrejtjes mbrojtja e të dobët, respektimi i pakicave dhe diversitetit.

Librat që do të shpërndahen nëpër shkolla janë:

1. Tri sprova mbi letërsinë botërore: Eskil, Dante, Shekspir, I. Kadare
2. Kronikë në gur, I. Kadare
3. Gjenerali i ushtrisë së vdekur, I. Kadare
4. Princi i Vogël, Antoine de Saint Exupery
5. E bardha dhe e zeza, Malorie Blackman
6. Çunat nuk qajnë, Malorie Blackman
7. Babeli, Jan De Leeuw
8. Gjuetari i balonave, Khaled Hosseini
9. Alkimisti, Paolo Coelho
10. Une jam Malala, Malala Yousafzai
11. Fundamentalist padashje, Mohsin Hamid
12. Pa zemër në kraharor, Mira Meksi

Prania e librave në bibliotekat e shkollave nuk është garanci për leximin e tyre, dhe rritja e numrit të lexuesve është mision i vështirë:

Kështu, KShH do të hartojë një udhëzues mbi përdorimin e literaturës për një edukim bazuar në vlera, i cili do t'i ndihmojë dhe motivojë mësuesit të promovojnë leximin midis studentëve dhe të zbatojnë aktivitete të ndryshme edukative me pjesëmarrjen e komunitetit.

Mësuesit kanë nevojë gjithashtu për mbështetje dhe trajnime të vazhdueshme me qëllim rritjen e kapaciteteve të tyre:

Për këtë qëllim, Komiteti Shqiptar i Helsinkit do të organizojë trajnime me 24 mësues dhe 15 psikologë të shkollave të mesme lidhur me konceptin dhe përkufizimin e radikalizmit, dhunës, marginalizimit, përjashtimit shoqëror, izolimit dhe mënyrën e përdorimit të letërsisë dhe veprimtarive edukative rreth veprës letrare për edukimin e të rinjve me vlera thelbësore për parandalimin e radikalizmit që çon në ekstremizëm të dhunshëm.

Gjatë trajnimit, mësuesit do të nxiten dhe aftësohen për të organizuar lloje të

ndryshme të veprimtarive edukative dhe aktiviteteve, mbi arsimin e bazuar në vlera, të cilat do të përsëriten në të paktën 6 shkolla, si: **Klubet e Leximit; Dramatizime të ndryshme, Konkurse për pikturë dhe ekspozita.**

Gjatë kohëzgjatjes së projektit Komiteti Shqiptar i Helsinkit do të mentorojë mësuesit dhe psikologët në 24 shkolla mbi zbatimin e aktiviteteve të bazuara në vlera!

Ndër të tjera KShH do të realizojë një sondazh në fillim dhe në fund të projektit, i cili synon gjithashtu të evidentojë dhe të analizojë ndryshimin e situatës lidhur me elementet e sipërpërmendur, pas zbatimit të kësaj nisme.

Në këtë projekt, një rol të rëndësishëm kanë edhe krerët e komuniteteve fetare. Cili do të jetë angazhimi i tyre?

Në bashkëpunim me krerët e komuniteteve fetare në Shqipëri, KShH do të realizojë një workshop rezultati i të cilit do të jetë prodhimi i një spoti televiziv me mesazhe për promovimin e tolerancës dhe dialogut ndërfaqetor, vlera të shoqërisë tonë!

1 Qarku i Beratit:

- Shkolla e mesme e përgjithshme "Sali Gjuka" Ura Vajurore
- Gjimnazi Kristaq Capo, Berat

2 Qarku i Dibrës:

- Gjimnazi "Arbëria" Bulqizë
- Shkolla "Said Nejdini", Peshkopi

3 Qarku i Durrësit:

- Shkolla e Mesme "16 shtatori" Shijak
- Shkolla e Mesme "Manëz", Tiranë

4 Qarku i Elbasanit:

- Shkolla e mesme pedagogjike "Luigj Gurakuqi", Elbasan
- Gjimnazi "Shefqet Guzi" Gramsh

5 Qarku i Fierit:

- Gjimnazi "18 Tetori" Lushnje
- Shkolla e Mesme "Miti Zoi Zaka" Divjakë

6 Qarku i Gjirokastrës:

- Gjimnazi "Asim Zeneli", Gjirokastrë
- Shkolla e Mesme e Bashkuar, Bularat

7 Qarku i Korçës:

- Shkolla e Mesme "Raqi Qirinxi" Korçë
- Gjimnazi "Muharrem Çollaku" Pogradec

8 Qarku i Kukësit:

- Shkolla e Mesme "Ahmet Voka" Kukës
- Gjimnazi "Skënderbeu" Has

9 Qarku i Lezhës:

- Shkolla e Mesme Profesionale "Kolin Gjoka" Lezhë
- Shkolla e Mesme "Bardhok Biba" Rrëshen, Mirditë

10 Qarku i Shkodrës:

- Shkolla e Mesme "Jordan Misja", Shkodër
- Shkolla e Mesme e Bashkuar "Adem Haxhija", Postrribë

11 Qarku i Tiranës:

- Gjimnazi "Ibrahim Rugova", Kamëz
- Shkolla e Mesme "Isa Boletini" Vorë

12 Qarku i Vlorës:

- Shkolla e Mesme e Përgjithshme "Ali Demi" – Vlorë
- Shkolla e Mesme "Spiro Gjikhuri" Himarë

Lista e Shkollave të Mesme në 12 qarqet e Shqipërisë të përfshira në këtë projekt:

